
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	ZYRA E PERSONELIT KANCELARIJA OSOBLJA		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.253 /22	Data: 25.10.2022	

Në mbështetje të nenit 2 paragrafi 2, nenit 79 dhe 80 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës si dhe Rregullores (QRK)Nr.05/2022 për Procedurat Konkurruese dhe Pranimi i Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, Komuna e Istogut shpall:

K O N K U R S

Titulli i vendit të punës:Roje Pylli

Institucioni: Komuna e Istogut

Drejtoria: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi

Numri i pozitave : 1 (një)

Titulli i Mbikëqyrësit: Udhëheqësi i Sektorit për Pylltari

Grada/Koeficienti: Koeficienti 4.5

Orët e Punës: 40 orë në javë

Periudha e Kontratës: Në kohë të pacaktuar

Kohëzgjatje e periudhës provuese: Gjashtë (6) muaj

Përshkrimi i detyrave dhe Përgjegjësi:

1. Merr detyra nga Udhëheqësi i Sektorit të Pylltarisë dhe nga Tekniku i Pylltarisë ;
2. Ruan pyjet nga prerja ilegale, nga zjarret dhe dëmtimet tjera,
3. Ruan florën dhe faunën e pyjeve;
4. Bënë vulosjen e drurëve të prerë;
5. Jep fletë përcjellëse për transportin e druve të vulosura dhe të prera legalisht ;
6. Shkruan fletëparaqitje dhe i paditë në gjykatat përkatëse personat që bëjnë dëmtimin e pyllit;
7. I raporton teknikut për pylltari dhe udhëheqësit të pylltarisë;
8. Paraqet raporte pune mujore, periodike dhe vjetore;
9. Kryen punë dhe detyra tjera nga fushëveprimtaria e sektorit përkatës , në pëputhje me ligjin dhe për punën i përgjigjet Udhëheqësit të Sektorit dhe Drejtorit të DBPH.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë për konkurim - punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgaditjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë për kryerjen e detyrave të punës.

Kualifikimi profesional, aftësitë:

- Përgaditja shkollore e mesme, drejtimi Teknik i Pylltarisë;
- Përvoja e kërkuar e punës: së paku 2 vite përvojë pune;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme të komunikimit në gjuhën zyrtare;
- Aftësi për të hartuar informatë, njoftime, shkresa dhe korrespondencë tjetër.

Dokumentet e kërkuara:

- Dëshmia përkatëse për posedimin e diplomës së shkollës së mesme
- Dëshmi të përvojës së punës
- Dy rekomandime
- Letërnjoftimi
- Ekstrakti nga libri amë i të lindurve
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime nga gjykata

Konkursi mbetet i hapur: **8 ditë, prej datës 24.11.2022 deri 01.12.2022**

Kandidatët e interesuar aplikacionet mund ti marrin në formë fizike, çdo ditë pune, në Qendrën për Shërbime me Qytetar, dhe të plotësuara ti dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, zyra nr.100- kati i parë, në ndërtesën e Komunës.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hynë në listën e ngusht do të ftohen në intervistë. Mirëpritën aplikacionet prej meshkujve dhe femrave të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranoen dhe aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të njoftohen për vendin, datën dhe kohën e mbajtjes së testimit me gojë përmes Web faqes zyrtare të komunës dhe tabelës së shpalljeve publike të Komunës.

Rezultatet shpallen në web faqe e komunës dhe tabelës së shpalljeve.

Menaxheri i Personelit
Fatmir Bytyçi

